



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I ARTEVE

PLANI I VEPRIMIT 2025–2030

Prill, 2025

PËRMBAJTJA E TABELËS

I. PJESA HYRËSE	4
Përmbledhje Ekzekutive	4
1. Parathënie institucionale e planit të veprimit	5
2. Hyrje.....	6
3. Objektivat strategjike dhe operacionalë.....	7
3.1. Objektivat strategjike të Fakultetit të arteve (2025–2030)	7
Tabela 3A. Objektiva strategjike.....	7
3.2. Objektivat operacionalë të planit të veprimit	7
Tabela 3B. Lidhja Strategjike–Operative–Vepruese	7
Tabela 3C. KPI dhe Monitorimi	8
4. Qasja metodologjike	9
5. Struktura e planit të veprimit.....	10
6. Menaxhimi i Rreziqeve dhe Masat Parandaluese.....	11
Tabela 6A. Përmbledhje e Rreziqeve dhe Masave Parandaluese	11
II. Zbatimi Tematik dhe Objektivat Operacionalë	12
7. Zbatimi sipas Objektivave Operacionalë (OBJ1 – OBJ7 + Shtesa Tematike)	12
Shtesat Tematike	26
Shtojca A: Inovacioni artistik, kërkimi ndërdisiplinor dhe lidhja me industrinë krijuese.....	26
Shtojca B: Digjitalizimi i avancuar dhe modernizimi i kampusit	28
Shtojca C: Etika institucionale, integriteti akademik dhe pronësia intelektuale.....	30
8. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi	32
8.1. Mekanizmat dhe Mjetet për Monitorimin dhe Raportimin e Planit të Veprimit .	33
8.1.1 Mekanizmat Institucionalë Kryesorë.....	33
8.1.2 Mjetet dhe Format e Mbledhjes së të Dhënave.....	33
8.1.3. Raportimi dhe Integrimi i Rezultateve	34
8.2. Tabela e Përgjegjësiwe Institucionalë për Zbatimin e Planit të Veprimit	34
8.3. Lidhja me Standardet Evropiane të Cilësisë	36

9.	Buxheti, Alokimi i Burimeve dhe Qëndrueshmëria Financiare	37
	Tabela 9.1a – Alokimi i Parashikuar i Buxhetit sipas Objektivave Operacionale (2025–2030)	38
	Tabela 9.1b. Tabela përmbledhëse e burimeve financiare sipas objektivave (2025–2030)	39
III.	Shtojcat mbështetëse.....	41
	Shtojca D: Lista e dokumenteve mbështetëse	41
	Shtojca E– Qasja institucionale ndaj Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes	42
	Shtojca F – Tabela e buxhetit të përllogaritur (2025–2030)	43
	Shtojca G. Përputhja me Planin Strategjik dhe Zhvillimor	44
	Shtojca H – Fjalori i termave dhe akronimeve	45

Ky dokument është pjesë integrale e dosjes së akreditimit për Fakultetin e Arteve dhe është i lidhur drejtpërdrejt me Planin Strategjik dhe Planin e Zhvillimit 2025–2030. Të gjitha informacionet janë të harmonizuara për të përmbushur standardet e KShC-së dhe kërkesat e ESG.

I. PJESA HYRËSE

Përmbledhje Ekzekutive

Plani i Veprimit 2025–2030 i Fakultetit të Arteve përfaqëson një kornizë të integruar për zbatimin e objektivave strategjike të institucionit, të përkthyer në masa konkrete, të matshme dhe të buxhetuara. Ai mbulon të tri departamentet akademike – Arte Vizuale, Muzikë dhe Dramë – dhe synon të nxisë cilësinë akademike, kërkimin artistik, digjitalizimin, ndërkombëtarizimin dhe qeverisjen e qëndrueshme.

Plani është i ndarë në tre pjesë kryesore:

- Pjesa hyrëse ofron bazën institucionale dhe metodologjike të planit;
- Kapitulli II përmbledh zbatimin konkret sipas shtatë objektivave operacionalë dhe tre shtesave tematike;
- Kapitulli III përfshin shtojcat mbështetëse, përfshirë analizën e rreziqeve, indikatorët e performancës dhe buxhetin total prej €1,209,500.

Përmes këtij dokumenti, Fakulteti angazhohet për menaxhim të efektshëm, transparencë dhe përmirësim të vazhdueshëm institucional, në përputhje me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë dhe me aspiratat strategjike të Universitetit të Prishtinës.

1. Parathënie institucionale e planit të veprimit

Plani i Veprimit 2025–2030 i Fakultetit të Arteve përfaqëson një dokument operacional strategjik, që përkthen objektivat afatgjata të institucionit në ndërhyrje konkrete dhe të matshme. I ndërtuar mbi bazën e Planit Strategjik dhe Planit të Zhvillimit, ky plan synon të garantojë cilësi të lartë akademike, inovacion të qëndrueshëm, qeverisje të përgjegjshme dhe ndikim të gjerë kulturor dhe shoqëror.

Dokumenti artikulon pesë objektiva strategjike dhe tetë objektiva operacionalë që adresojnë mësimdhënien, kërkimin, digjitalizimin, ndërkombëtarizimin, përfshirjen, etikën dhe bashkëpunimin me komunitetin. Çdo objektiv shoqërohet me tregues të matshëm (KPI), burime të përcaktuara, afate dhe struktura përgjegjëse për zbatim.

Ky plan është rezultat i një procesi gjithëpërfshirës konsultimi me stafin akademik, administrativ, studentët dhe partnerët institucionalë. Ai ofron një udhërrëfyes të besueshëm për menaxhimin efektiv të burimeve, zhvillimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm institucional, në përputhje me standardet evropiane të sigurimit të cilësisë dhe aspiratat strategjike të Universitetit të Prishtinës.

2. Hyrje

Plani i Veprimit i Fakultetit të Arteve (2025–2030) përkthen objektivat strategjike të përcaktuara në dokumentet themelore të institucionit në veprime të qarta dhe të zbatueshme. Ai përfshin të gjitha njësitë akademike – Departamentin e Arteve Vizuale, të Muzikës dhe të Dramës – duke ofruar një qasje të integruar për zhvillim të qëndrueshëm dhe ndikim të matshëm.

Dokumenti përmban:

- Një strukturë të qartë të objektivave strategjike dhe operacionale,
- Një kornizë të indikatorëve të performancës (KPI),
- Buxhetin e parashikuar sipas objektivave,
- Kalendarin e zbatimit,
- Mekanizmat për monitorim, vlerësim dhe raportim.

Ai shërben si instrument për avancimin institucional, marrjen e vendimeve të bazuara në evidencë dhe përmbushjen e standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë në arsimin e lartë artistik.

3. Objektivat strategjike dhe operacionale

3.1. Objektivat strategjike të Fakultetit të arteve (2025–2030)

Plani Strategjik 2025–2030 përfshin pesë objektiva strategjike, secili prej të cilëve përkthehet në objektiva operative brenda këtij Plani të Veprimit. Në total, janë tetë objektiva operative që udhëheqin zbatimin e aktiviteteve në të gjithë Fakultetin e Arteve. Disa prej tyre janë ndërsektorialë dhe trajtojnë përparësi institucionale si etika, përfshirja dhe transformimi digjital.

Përafrimi ndërmjet objektivave strategjike dhe atyre operative paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela 3A. Objektiva strategjike

Kodi	Objektivi strategjik
OS1	Cilësia Akademike dhe Kurrikula
OS2	Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni Artistik
OS3	Infrastruktura dhe Digjitalizimi
OS4	Ndërkombëtarizimi
OS5	Angazhimi me Alumnistët dhe Komunitetin

3.2. Objektivat operacionale të planit të veprimit

Secili objektiv operativ korrespondon me një objektiv strategjik dhe e përkthen atë në ndërhyrje konkrete — përmes aktiviteteve, trajnimeve, investimeve dhe veprimeve institucionale.

Tabela 3B. Lidhja Strategjike–Operative–Vepruese

Objektivi strategjik (os)	Objektivi(et) operacional(e)	Prioritete të përgjithshme
OS1 – Cilësia Akademike dhe Kurrikula	Obj.1 – Mësimdhënie dhe Mentorim Obj.2 – Reforma e Kurrikulës Obj.7 – Etikë dhe Përfshirje	Përfshirje, Etikë
OS2 – Kërkimi Artistik dhe Krijimtaria	Obj.3 – Projekte Kërkimore	Inovacion, Ndërdisciplinaritet
OS3 – Infrastruktura dhe Mjedisi i të Nxënës	Obj.4 – Mjete Digjitale Obj.8 – Qeverisje Institucionale	Qëndrueshmëri, Digjitalizim
OS4 – Ndërkombëtarizimi dhe Rrjetet Globale	Obj.5 – Mobilitet dhe Partneritete	Shumëgjuhësi, Vizibilitet Global
OS5 – Alumni dhe Angazhimi me Komunitetin	Obj.6 – Angazhim Qytetar Obj.7 – Etikë dhe Përfshirje Obj.8 – Qeverisje Digjitale	Transparencë, Ndikim Qytetar

Tabela 3C. KPI dhe Monitorimi

Objektivi Operacional (OBJ)	Treguesi Kryesor i Performancës (KPI)	Viti i Synuar	Frekuenca e Matjes	Burimi i të Dhënave	Njësia Përgjegjëse
Obj.1 – Cilësia e mësimdhënies dhe mentorimi i studentëve	≥85% shkallë kënaqësie e studentëve deri më 2027	2027	Vjetore	Anketa të studentëve	Zyra e Cilësisë, Departamentet
Obj.2 – Reforma e kurrikulës dhe përputhja me tregun e punës	100% e programeve BA/MA të rishikuara deri më 2026	2026	Çdo dy vjet	Raportet e Këshillit të Programeve	Komiteti i Kurrikulës
Obj.3 – Kërkimi artistik dhe projektet ndërdepartamentale	15 projekte ndërdisiplinore të përfunduara deri më 2030	2030	Vjetore	Raportet e Institutit të Arteve	Instituti i Arteve
Obj.4 – Infrastruktura dhe mjetet digjitale	10 hapësira mësimore të modernizuara deri më 2028	2028	Çdo dy vjet	Raportet e Njesisë së Infrastrukturës	Zyra e Dekanit, Njësia e Infrastrukturës
Obj.5 – Mobiliteti ndërkombëtar dhe partneritetet	≥50 mobilitete në vit duke filluar nga 2026	Çdo vit	Vjetore	Zyra për Marrëdhëniet Ndërkombëtare	Zyra për Marrëdhëniet Ndërkombëtare
Obj.6 – Angazhimi i alumneve dhe komunitetit	3 aktivitete në vit me alumnit dhe komunitetin	Çdo vit	Vjetore	Raportet e Zyrës së Alumneve	Zyra për Alumni dhe Bashkëpunim me Publikun
Obj.7 – Etika, barazia gjinore dhe qeverisja gjithëpërfshirëse	Politika për etikën dhe përfshirjen miratohet deri më 2026	2026	Njëherë	Zyra e Dekanit & Këshilli	Sekretariati Akademik
Obj.8 – Qeverisja institucionale dhe digjitale	90% e shërbimeve akademike të digjitalizuara deri më 2030	2030	Vjetore	Raportet e Shërbimeve Digjitale	Sekretariati Administrativ & IT

Shënim: Kjo matricë monitorimi do të shërbejë si mjeti kryesor i brendshëm për raportim vjetor të progresit, rishikim afatmesëm (2027), dhe vlerësim përfundimtar (2030), si dhe për raportimin në kuadër të akreditimit.

4. Qasja metodologjike

Ky Plan Veprimi bazohet në metodologjinë institucionale të përshkruar në Planin Strategjik të Fakultetit të Arteve 2025–2030. Ai është gjithashtu i harmonizuar me politikat kombëtare të arsimit të lartë dhe me Standardet dhe Udhëzimet Evropiane (ESG) për sigurimin e cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).

Qasja metodologjike ndërtohet mbi pesë parime udhëzuese:

1. **Pjesëmarrja dhe konsultimi** – Përfshirja e stafit akademik, studentëve, alumnive dhe aktorëve të jashtëm në të gjitha fazat e procesit të planifikimit;
2. **Përputhshmëria institucionale** – Sigurimi që të gjitha objektivat, veprimet dhe treguesit të jenë në harmoni me misionin, vizionin dhe prioritetet strategjike të Fakultetit;
3. **Matshmëria dhe monitorimi** – Hartimi i treguesve të qartë të performancës (KPI), vendosja e vlerave të synuara dhe ngritja e mekanizmave për vlerësimin e vazhdueshëm të progresit;
4. **Qëndrueshmëria dhe realizueshmëria** – Planifikimi i veprimeve realiste, të përballueshme dhe në përputhje me kapacitetet institucionale dhe objektivat afatgjata të zhvillimit;
5. **Transparenca dhe llogaridhënia** – Promovimi i komunikimit të hapur, ndarja e përgjegjësi të qarta dhe angazhimi për raportim publik dhe mbikëqyrje të brendshme.

Këto parime kanë udhëhequr të gjithë procesin e hartimit të planit – nga përputhja strategjike te dizajnimi operacional, përzgjedhja e treguesve, buxhetimi dhe koordinimi institucional. Ato do të vazhdojnë të jenë baza e zbatimit, monitorimit dhe vlerësimit të Planit të Veprimit gjatë gjithë periudhës 2025–2030.

5. Struktura e planit të veprimit

Plani i Veprimit 2025–2030 është ndërtuar mbi një strukturë funksionale që lehtëson zbatimin, vlerësimin dhe përshtatjen e vazhdueshme të objektivave strategjikë të Fakultetit të Arteve. Ai është konceptuar sipas parimeve të menaxhimit të ciklit të projektit, duke siguruar lidhjen logjike midis qëllimeve institucionale, veprimeve të planifikuara dhe rezultateve të synuara.

Struktura përfshin komponentët vijues:

- **Objektivat Operacionalë:** Të nxjerra nga objektivat strategjikë të institucionit, të ndërlidhura drejtpërdrejt me rezultatet e pritshme në mësimdhënie, kërkim, qeverisje dhe ndërkombëtarizim.
- **Veprimet dhe Aktivitetet Konkretizuese:** Të ndara sipas fushave përkatëse të veprimit, me kalendar zbatimi, indikatorë dhe ndarje përgjegjësish.
- **Treguesit e Performancës (KPI):** Të përkufizuar në mënyrë të matshme dhe të krahasueshme, për të siguruar monitorim objektiv dhe raportim periodik.
- **Buxheti i Përlllogaritur dhe Burimet e Financimit:** I detajuar sipas objektivave dhe aktiviteteve, në përputhje me kapacitetet financiare të institucionit dhe mundësitë për mbështetje të jashtme.
- **Mekanizmat e Zbatimit dhe Vlerësimit:** Qartësisht të strukturuar për të garantuar koordinim institucional, transparencë dhe përgjegjësi në çdo fazë të procesit.

Kjo strukturë siguron që Plani i Veprimit të jetë i zbatueshëm, i monitorueshëm dhe i përditësueshëm në përputhje me zhvillimet e brendshme dhe kontekstin e jashtëm.

6. Menaxhimi i Rreziqeve dhe Masat Parandaluese

Ky kapitull përfshin qasjen institucionale dhe praktike të Fakultetit të Arteve për menaxhimin e rrezikut gjatë zbatimit të Planit të Veprimit 2025–2030. Rreziqet analizohen në funksion të shtatë objektivave operacionale, secili i shoqëruar me vlerësime specifike dhe masa parandaluese të përshtatura për fushën përkatëse.

Rreziqet janë të klasifikuara në pesë kategori themelore:

- Strategjike,
- Operacionale,
- Financiare,
- Teknologjike dhe
- Socio-kulturore.

Për secilin objektiv janë identifikuar sfidat më të mundshme dhe janë propozuar mekanizma parandalues për të ruajtur stabilitetin institucional dhe për të mbështetur zbatueshmërinë e planit.

Procesi i menaxhimit të rrezikut mbikëqyret nga Zyra e Dekanit dhe Zyra për Sigurimin e Cilësisë, me rishikim vjetor në kuadër të raportit të progresit dhe rishikim të thelluar në vitin 2027 si pjesë e vlerësimit në mes të periudhës. Efektiviteti i këtij sistemi mbështetet në katër faktorë kyç: stabiliteti i politikave arsimore, autonomia institucionale, përfshirja aktive e palëve të interesit dhe sigurimi i burimeve të nevojshme financiare.

Tabela 6A. Përmbledhje e Rreziqeve dhe Masave Parandaluese

Objektivi Operacional	Rreziku Kryesor	Masa Parandaluese
OBJ1 – Cilësia e mësimdhënies dhe mentorimi	Mospjesëmarrja në zhvillim profesional	Lidhja e trajnimeve me vlerësimin e stafit; certifikime për pjesëmarrje
OBJ2 – Reforma e kurrikulës	Vonesa për shkak të ngarkesës dhe mungesës së stafit	Prioritizim i programeve; shpërndarje e drejtë e punës
OBJ3 – Kërkimi dhe projektet ndërdisiplinore	Motivim i ulët për kërkime	Lidhja e kërkimit me ngritjen akademike dhe lirim nga orët
OBJ4 – Infrastruktura dhe digjitalizimi	Vonesa në prokurim dhe mungesë mjetesh IT	Planifikim i hershëm; investim në 2 vitet e para
OBJ5 – Ndërkombëtarizimi	Mungesë kompetencash gjuhësore dhe informimi	Kurse gjuhësore; qendër për mobilitetin
OBJ6 – Alumni dhe bashkëpunimi me komunitetin	Përgjigje e ulët nga alumni; pak partneritete	Platformë digjitale; përfshirje në evente dhe borde këshillëdhënëse
OBJ7 – Qeverisja gjithëpërfshirëse dhe etika	Mospërkrahje për politikat e përfshirjes	Fushata vetëdijesimi; përfshirje në hartimin e kodeve dhe politikave

II. Zbatimi Tematik dhe Objektivat Operacionalë

7. Zbatimi sipas Objektivate Operacionalë (OBJ1 – OBJ7 + Shtesa Tematike)

Përveç pasqyrës së përgjithshme të rreziqeve të trajtuara në Kapitullin 6, çdo objektiv operacional është i shoqëruar me analiza të detajuara dhe të kontekstualizuara për sfidat e mundshme dhe masat parandaluese përkatëse. Kjo qasje siguron një ndërlidhje të qartë ndërmjet planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit, duke rritur transparencën dhe përmirësimin e vazhdueshëm institucional.

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet konkrete të planifikuara për arritjen e këtij objektiivi operacional, së bashku me indikatorët e performancës, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatim.

OBJEKTIVI OPERACIONAL		1:	RRITJA E CILËSISË SË MËSIMDHËNIES DHE TË NXËNIES				
QËLLIMI:	Ky objektiv operacional rrjedh nga Objektivi Strategjik 1 i Planit Strategjik dhe synon përmirësimin e përvojës akademike të studentëve përmes metodave bashkëkohore të mësimdhënies, përfshirjes aktive të studentëve, vlerësimit të brendshëm dhe zhvillimit të vazhdueshëm të stafit. Qëllimi është të fuqizohen proceset pedagogjike në përputhje me standardet ESG dhe nevojat e shoqërisë, duke nxitur një kulturë të cilësisë, reflektimit kritik dhe inovacionit në mësimdhënie e të nxënë.						
TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)							
TREGUESI						TARGET DERI MË 2030	
Përqindja e stafit me trajnime vjetore						≥ 70%	
Përqindja e studentëve të kënaqur						≥ 85%	
Stafi i rregullt me gradë shkencore						≥ 80%	
Përmirësimi i vlerësimit të programeve						≥ 20% rritje në cilësi	
Numri i mentorimeve student–staf						≥ 100 mentorime/vit	
AKTIVITETET KRYESORE							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi	Udhëheqësi	Partnerë	Rezultatet
1.1	Trajnime për mësimdhënie bashkëkohore dhe teknika	2025 – 2030	45,000	UP, donator ë	Fakulteti	Qendra për zhvillim të stafit	Përmirësim i praktikave të mësimdhënies

	pedagogjike për stafin akademik						
1.2	Vlerësimi sistematik i performancës akademike dhe përmirësimi në bazë të rezultateve	Vjetor	0	Fakulteti	Dekanati	—	Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë
1.3	Implementimi i sistemit të mentorimit për studentët nga stafi akademik	2026	1,000	Fakulteti	Administrata	Alumni	Rritja e angazhimit të studentëve
1.4	Përfshirja e feedback-ut të studentëve në planifikimin e orëve dhe aktiviteteve mësimore	2025 – 2030	0	Fakulteti	Departamenti	Këshilli Studentor	Mësimdhënie më e përshtatur dhe përfshirëse
1.5	Inkurajimi i bashkëpunimeve ndërdisiplinore dhe punës në grup mes studentëve të profileve	2025 – 2027	4,000	Fakulteti	Koordinatorët	Partnerë vendorë	Nxitje e punës krijuese ndërdisiplinore
GJITHSEJ:			50,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Rezistencë ndaj trajnimeve				Trajnime të detyrueshme të lidhura me përfitime dhe promovime			
Mungesë kohe për mentorim				Përcaktim formal në ngarkesën mësimore			
Mungesë feedback-u cilësor				Anketa të dizajnuara profesionalisht dhe anonime			
INDIKATORË PËR IMPAKTIN AFATGJATË							
OBJEKTIVI 1		CILËSIA NË MËSIMDHËNIE:					
INDIKATORË IMPAKTI:							
- Rritje e perceptimit pozitiv për cilësinë e mësimdhënies në anketat institucionale (>25% deri më 2030). - Rritje e angazhimit të studentëve në procesin akademik dhe vendimmarrje (>50% studentë të përfshirë në aktivitete akademike). - Konsolidim i një kulture reflektuese dhe bashkëpunuese midis stafit dhe studentëve.							

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet konkrete të planifikuara për arritjen e këtij objekti operacional, së bashku me indikatorët e performancës, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatim.

OBJEKTIVI OPERACIONAL			2:	MODERNIZIMI I KURRIKULËS DHE PËRAFRIMI ME TREGUN E PUNËS			
QËLLIMI:		Ky objektivi, gjithashtu i ndërlidhur me Objektivin Strategjik 1, fokusohet në përditësimin e përmbajtjes dhe strukturës së programeve studimore në përputhje me nevojat e tregut të punës, trendet bashkëkohore në art dhe teknologji, dhe kërkesat e mobilitetit akademik. Ai mbështet ndërtimin e moduleve fleksibile dhe ndërdisiplinore, si dhe integrimin e praktikës profesionale në studime.					
TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)							
TREGUESI						TARGET DERI MË 2030	
Numri i programeve të rishikuara						Të gjitha BA dhe MA	
Module të reja me orientim praktik/tregu						≥10 module	
Pjesëmarrja e partnerëve të jashtëm në kurrikula						≥1 konsultim për program	
Praktika profesionale e integruar në kurrikula						≥80% e programeve BA	
Studentë në praktika reale						≥60% për çdo vit	
AKTIVITETET KRYESORE							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi	Udhëheqësi	Partnerë	Rezultate
2.1	Analizë krahasimore e kurrikulave me universitete të BE	2025	0	Fakulteti	Këshilli i Programeve	Universitetet homologe	Rekomandime për përputhje me standarde evropiane
2.2	Tryeza me përfaqësues të industrive kreative për konsultim në dizajn kurrikular	2025–2026	4,000	Komuna, MKRS	Fakulteti	Galeri, agjenci, studio	Sugjerime për module praktike
2.3	Rishikimi i të gjitha planeve mësimore BA dhe MA	2025–2027	0	Fakulteti	Komisionet e programeve	—	Kurrikula të harmonizuara me ESG dhe ECTS
2.4	Futja e moduleve ndërdisiplinore dhe digjitale (AI, dizajn zëri, art & media të reja)	2026–2028	6,000	UP, Erasmus+	Departamentet	Partnerë të jashtëm	Module që rrisin punësueshmërinë dhe kompetencat digjitale
2.5	Integrimi i praktikës në programe dhe marrëveshje me	2026–2030	2,000	Fakulteti, sponsorë	Administrata + Dekanati	Galeri, festivale	Studentët fitojnë përvojë të drejtpërdrejtë në fushë

	institucione kulturore						
2.6	Anketa vjetore për përmbajtjen e moduleve të reja	2027–2030	0	Fakulteti	Sekretaria Akademike	Studentët, alumni	Vlerësim dhe përmirësim i vazhdueshëm
GJITHSEJ:			12,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Përfshirje e pamjaftueshme nga partnerët				Nënshkrim MoU formal dhe përfshirje në komisione			
Ngarkesë e madhe e stafit për përditësim				Përcaktim afatesh fleksibël dhe ndarje e qartë rolesh			
Mungesë eksperience në dizajn të moduleve të reja				Trajnime për dizajn kurrikulash të bazuara në rezultate të të nxënit			
INDIKATORË PËR IMPAKTIN AFATGJATË							
OBJEKTIVI 2		MODERNIZIMI I KURRIKULËS					
INDIKATORË IMPAKTI:							
- Rritje e punësueshmërisë së të diplomuarve në sektorë të lidhur me programet e studimit ($\geq 70\%$ e punësuar brenda 1 viti). - Zhvillimi i një modeli fleksibël dhe të përsëritshëm për rishikimin periodik të kurrikulës (model institucional i miratuar). - Themelimi i moduleve që ndihmojnë tranzicionin nga studimet në karrierë (≥ 10 module të dizajnuara me industri kreative).							

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet konkrete të planifikuara për arritjen e këtij objekti operacional, së bashku me indikatorët e performancës, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatim.

OBJEKTIVI OPERACIONAL			3:	ZHVILLIMI I KAPACITETEVE KËRKIMORE DHE KRIJUESE			
QËLLIMI:		Të ndërtohet një kulturë e përmirësimit të vazhdueshëm, vlerësimit të brendshëm dhe transparencës në të gjitha nivelet institucionale.					
TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)							3
TREGUESI						TARGET DERI MË 2030	
Projekte kërkimore të mbështetura në vit						≥10	
Prezantime ndërkombëtare në konferenca/ekspozita						≥8 në vit	
Botime në revista ose katalogë të kualifikuar						≥3 në vit	
Marrëveshje për bashkëpunim kërkimor me institucione të tjera						≥5	
Grante të fituara për hulumtim artistik						≥100,000 € gjithsej	
AKTIVITETET KRYESORE							3
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi i mundshëm	Udhëheqësi i zbatimit	Partnerë të mundshëm	Rezultatet e pritshme
3.1	Hartimi i Planit të Hulumtimit për Fakultetin	2025	0	Fakulteti	Dekanat i	UP	Udhëzim strategjik për prioritetet dhe metodologjitë kërkimore në FA
3.2	Themelimi i Laboratorit për Inovacione dhe Kërkime Artistike	2026	150,000	UP, MKRS, projekte BE	Fakultet i	Creative Europe, MKRS	Infrastrukturë për zhvillim artistik dhe ndërveprim interdisciplinar
3.3	Organizimi i simpoziumeve dhe ekspozitave kërkimore ndërkombëtare	Vjetor	75,000	UP, BE, MKRS, Erasmus +	Departamentet	Galeri, universitet e rajonale	Platforma të prezantimit dhe debatit shkencor e artistik
3.4	Mbështetje për publikime shkencore, artistike dhe katalogë të dokumentuar	2025–2030	80,000	UP, MKRS, fondet e brendshme	Fakultet i	Revista, botues	Rritja e prezencës institucionale në platforma të dokumentimit profesional
3.5	Trajnime për studentët dhe stafin në metodologji hulumtimi artistik	2026–2030	18,000	UP, BE, organizat a partnere	Fakultet i	Qendra për Hulumtim e në UP	Kapacitete të avancuara për zhvillim të hulumtimit

	dhe kërkim të bazuar në praktikë						profesional dhe akademik
3.6	Platformë digjitale për arkivimin dhe shpërndarjen e projekteve hulumtuese	2026	9,000	Fakulteti	Sekretaria + QH	IT/Media team	Qasje publike dhe transparente në krijimtarinë dhe hulumtimin e stafit e studentëve
GJITHSEJ:			332,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Mungesë fondesh të mjaftueshme për laboratorin kërkimor				Aplikim në thirrje ndërkombëtare (Creative Europe, Erasmus+)			
Mungesë e motivimit për botime ose kërkim nga stafi				Futja e kërkimit si komponent në vlerësimin institucional dhe avancimin profesional			
Vështirësi në sigurimin e bashkëpunimeve të jashtme				Rrjetëzim proaktiv dhe pjesëmarrje në aktivitete akademike rajonale dhe ndërkombëtare			
INDIKATORË PËR IMPAKTIN AFATGJATË							
OBJEKTIVI 3	ZHVILLIMI I KAPACITETEVE KËRKIMORE DHE KRIJUESE						
INDIKATORË IMPAKTI:							
- Krijimi i një kulture institucionale të hulumtimit artistik dhe akademik të integruar në jetën e përditshme të fakultetit. - Rritje e numrit të profesorëve dhe studentëve me prezantime në forume ndërkombëtare. - Përfshirja e kërkimit në vlerësimin dhe avancimin profesional të stafit akademik.							

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet konkrete të planifikuara për arritjen e këtij objektivit operacional, së bashku me indikatorët e performancës, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatim.

OBJEKTIVI OPERACIONAL		4:	PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS DHE DIGJITALIZIMIT TË MJEDISIT AKADEMIK				
QËLLIMI:	Ky objektiv operacional është në përputhje të drejtpërdrejtë me Objektivin Strategjik 3 të Planit Strategjik të Fakultetit të Arteve dhe synon modernizimin e hapësirave mësimore, krijuese dhe teknologjike, si dhe rritjen e qasjes digjitale për studentët dhe stafin. Duke krijuar kushte të favorshme për zhvillim akademik dhe artistik, fakulteti synon të përmirësojë mjedisin e të nxënit, sigurojë barazi në qasje dhe nxisë inovacionin.						
TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)							
TREGUESI						TARGET DERI MË 2030	
Klasa të rinovuara dhe të pajisura me teknologji modern						≥10 hapësira	
Sisteme të digjitalizuara për menaxhimin e mësimin						Të gjitha programet	
Qasje online në biblioteka/artikuj shkencorë						100% për të gjithë studentët	
Pajisje të reja për laboratorët e arteve vizuale dhe muzikës						Sipas planit të zhvillimit	
Sisteme të integruara për administratë dhe vlerësim						Të gjitha nivelet	
AKTIVITETET KRYESORE							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi i mundshëm	Udhëheqësi i zbatimit	Partnerë të mundshëm	Rezultatet e pritshme
4.1	Rinovimi dhe mobilimi i hapësirave të mësimdhënies në të tri departamentet	2025–2027	280,000	UP, MKRS, BE	Dekanat i + UP	MAShTI, donatorë	Klasa të përshtatura me standarde bashkëkohore të artit dhe teknologjisë
4.2	Pajisja e hapësirave me projektorë, sisteme audio, kompjuterë dhe rrjet të brendshëm	2026–2028	160,000	UP, IPA III, sponsorë	Njësitë teknike	Furnitorë IT dhe pajisje	Mësimdhënie interaktive dhe e integruar me teknologji
4.3	Krijimi i klasave të mençura (smart classrooms) për mësim të integruar me video, audio, streaming	2026–2030	80,000	UP, Erasmus+, BE	Fakultet i + IT	Universitet et partnere	Qasje fleksibile për leksione dhe demonstrime artistike
4.4	Platformë e brendshme për menaxhimin e	2026	10,000	UP	Sekretaria akademi ke	Agjenci digjitale	Administrim më efikas dhe transparent i

	orareve, provimeve, dhe vlerësimeve						ciklit të studimeve
4.5	Instalimi i rrjetit të dedikuar për labororët e arteve dhe hapësirat për praktikë	2025–2027	50,000	UP	Departamentet	IT Vendorë	Qasje stabile dhe e shpejtë në materiale digjitale dhe softuerë
4.6	Digjitalizimi i bibliotekës dhe qasja online në burime shkencore dhe artistike	2027	15,000	UP, donatorë	Bibliote ka e Fakultet it	Katalogë ndërkombë tarë	Rritje e cilësisë së studimit dhe hulumtimit përmes resurseve moderne
GJITHSEJ:			595,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Vonesat në procedura të prokurimit				Planifikim i hershëm dhe bashkëpunim me zyra të prokurimit të UP			
Fondet e pamjaftueshme për investime kapitale				Aplikim në thirrje të BE dhe partneritete me donatorë strategjikë			
Mungesë mirëmbajtjeje të pajisjeve të reja				Trajnim për mirëmbajtësit dhe krijimi i një plani për shërbime teknike			
INDIKATORË PËR IMPAKTIN AFATGJATË							
OBJEKTIVI 4	PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS DHE DIGJITALIZIMIT TË MJEDISIT AKADEMIK						
INDIKATORË IMPAKTI:							
- Përmirësim i qëndrueshëm i kushteve të punës për studentë dhe staf (>70% kënaqësi në sondazhe). - Përdorimi i mjeteve digjitale në mbi 50% të aktiviteteve praktike dhe mësimore. - Zvogëlim i hendekut në qasje teknologjike ndërmjet departamenteve dhe studentëve.							

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet konkrete të planifikuara për arritjen e këtij objektivit operacional, së bashku me indikatorët e performancës, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatim.

OBJEKTIVI OPERACIONAL		5:	NXITJA E NDËRKOMBËTARIZIMIT DHE MOBILITETIT AKADEMIK				
QËLLIMI:	Ky objektiv operacional është i lidhur ngushtë me Objektivin Strategjik 4 të Planit Strategjik dhe synon forcimin e lidhjeve ndërkombëtare të Fakultetit të Arteve përmes mobilitetit të studentëve dhe stafit, pjesëmarrjes në rrjete akademike dhe artistike evropiane, dhe zhvillimit të programeve e moduleve të përbashkëta me partnerë të huaj. Qasja globale e fakultetit do të rrisë cilësinë dukshmërinë dhe përvojën ndërkulturore për komunitetin akademik.						
TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)							
TREGUESI						TARGET DERI MË 2030	
Studentë në mobilitet jashtë vendit (Erasmus+, shkëmbime)						≥50 studentë në total	
Staf akademik në mobilitet (vizitor apo i dërguar)						≥30 staf për periudhën	
Marrëveshje ndërinstitucionale aktive						≥10 partneritete të reja	
Organizim i aktiviteteve ndërkombëtare në fakultet						≥3 çdo vit	
Module të përbashkëta në gjuhë të huaj						≥5 module deri më 2030	
AKTIVITETET KRYESORE							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi i mundshëm	Udhëheqësi i zbatimit	Partnerë të mundshëm	Rezultatet e pritshme
5.1	Hartimi i strategjisë së ndërkombëtarizimit për Fakultetin e Arteve	2025	0	Fakulteti	Dekanati + Koord. Erasmus	UP, KUI	Udhërrëfyes për veprime dhe prioritete të qarta ndërkombëtare
5.2	Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja me universitete të artit në Evropë dhe rajon	2025–2030	30,000	Fakulteti, KUI	Dekanati	Universitete partnere	Rritje e rrjeteve akademike dhe artistike
5.3	Lehtësimi i mobilitetit të studentëve dhe stafit përmes trajnimeve dhe informimit për Erasmus+	2025–2030	15,000	Erasmus+, UP	Koordinatori Erasmus	UP, Zyra Erasmus +	Rritje e pjesëmarrjes në mobilitet
5.4	Organizimi i shkollave verore, ekspozitave dhe punëtorive me	Vjetor	25,000	BE, donatorë	Departamentet	Universitete, artistë të huaj	Qasje ndërkombëtare për studentët dhe pasurim i përvojës

	pjesëmarrje ndërkombëtare						akademike e krijese
5.5	Futja e moduleve të përbashkëta në gjuhë të huaj dhe angazhimi i profesorëve vizitorë	2026–2030	40,000	Erasmus+, partnerë	Fakulteti	Profesorë ndërkombëtarë	Integrim i përmbytjes ndërkombëtare dhe përmirësim i cilësisë mësimore
5.6	Pjesëmarrje në rrjete dhe platforma evropiane për art, dizajn dhe kërkim artistic	2025–2030	12,000	UP, BE	Qendra për Hulumtimet	ELIA, ENCAT C, ISEA	Integrim në platforma të politikave dhe standardeve evropiane në fushën e artit
GJITHSEJ:			122,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Mungesë informimi dhe motivimi për mobilitet				Zhvillimi i fletushkave, takime informuese, përkrahje për aplikim			
Vështirësi gjuhësore te disa studentë/staf				Organizim i kurseve për gjuhë të huaj (anglisht) në bashkëpunim me qendra trajnimi			
Procedura të ngadalta administrative për marrëveshje				Koordinim me UP dhe përfshirje të hershme të sekretarive dhe menaxhmentit			
INDIKATORË PËR IMPAKTIN AFATGJATË							
OBJEKTIVI 5		NXITJA E NDËRKOMBËTARIZIMIT DHE MOBILITETIT AKADEMIK					
INDIKATORË IMPAKTI:							
- Rritje e dukshmërisë së Fakultetit në rrjete artistike dhe akademike ndërkombëtare (ENCATC, AEC, ELIA). - Themelimi i moduleve të përbashkëta me universitete të huaja (≥5 deri në 2030). - Kthimi i pjesëmarrësve nga mobilitetet me projekte të aplikuara në fakultet (p.sh., punëtori, ekspozita, ligjërata).							

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet konkrete të planifikuara për arritjen e këtij objekti operacional, së bashku me indikatorët e performancës, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatim.

OBJEKTIVI OPERACIONAL		6:		BASHKËPUNIMI ME KOMUNITETIN DHE ANGAZHIMI I ALUMNISTËVE			
QËLLIMI:	Në përputhje me Objektivin Strategjik 5 të Planit Strategjik të Fakultetit të Arteve, ky objektivi synon forcimin e lidhjeve ndërmjet institucionit dhe shoqërisë, përmes angazhimit të studentëve në aktivitete publike, ndërtimit të marrëdhënieve të qëndrueshme me alumnistët dhe kontributit të drejtpërdrejtë të fakultetit në zhvillimin kulturor e social të vendit. Kultura bashkëpunuese është thelbësore për një institucion të hapur dhe të përfshirë në komunitet.						
TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)							
TREGUESI						TARGET DERI MË 2030	
Numri i projekteve me komunitetin						≥30 aktivitete	
Platformë funksionale për alumnistët						1 platformë aktive	
Aktivitetet publike të studentëve						≥4 ngjarje në vit	
Angazhimi i alumnistëve në mësim dhe mentorim						≥20 alumnistë të përfshirë	
Ngjarje të përbashkëta me institucione kulturore						≥2 në vit	
AKTIVITETET KRYESORE							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi i mundshëm	Udhëheqësi i zbatimit	Partnerë të mundshëm	Rezultatet e pritshme
6.1	Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për bashkëpunim me komunitetin	2025	0	Fakulteti	Dekanati	OJQ, Komuna	Krijimi i një modeli të qëndrueshëm të angazhimit publik
6.2	Organizimi i aktiviteteve artistike dhe shfaqjeve në hapësira publike me përfshirjen e qytetarëve	Vjetor	20,000	MKRS, Komuna, donatorë	Departamentet	Galeritë, teatro, shkolla	Rritje e ndikimit social dhe ekspozim i talenteve të reja
6.3	Themelimi i një platforme digjitale për rrjetëzim me alumnistët dhe përfshirjen e tyre në jetën akademike	2025–2026	10,000	Fakulteti	Sekretaria	Alumnistët	Krijimi i një komuniteti aktiv dhe kontribuues të alumnistëve
6.4	Inkurajimi i pjesëmarrjes së alumnistëve në ligjërata të hapura,	2025–2030	5,000	Fakulteti, donatorë	Koordinatori për marrëdhënie me	Universitetet e tjera, rrjete artistësh	Përfitim i drejtpërdrejtë nga përvoja reale e profesionistëve për studentët

	mentorime dhe projekte artistike				alumnist ë		
6.5	Bashkëpunime të rregullta me shkolla të mesme artistike, festivale dhe institucione edukativo-kulturore	2026–2030	12,000	MKRS, partnerë lokalë	Fakulteti	Shkolla të mesme, festivale	Zgjatje e ndikimit të Fakultetit dhe ndërtim i bazës së ardhshme studentore
GJITHSEJ:			47,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Pjesëmarrje e ulët e alumnistëve				Krijimi i një platforme atraktive dhe incentivimi për përfshirje			
Interes i ulët i institucioneve partnere				Identifikim i hershëm i partnerëve dhe qasje me oferta bashkëpunimi të qarta			
Vështirësi logjistike në realizimin e aktiviteteve				Përcaktimi i afateve realiste dhe përfshirja e studentëve si bashkë organizatore			
INDIKATORË PËR IMPAKTIN AFATGJATË							
OBJEKTIVI 6		ANGAZHIMI I STUDENTËVE DHE KOMUNITETIT					
INDIKATORË IMPAKTI:							
- Rritje e pjesëmarrjes së studentëve në projekte që adresojnë çështje sociale, kulturore dhe mjedisore. - Ndikim i drejtpërdrejtë në komunitet përmes aktiviteteve artistike të hapura (≥30 aktivitete deri në 2030). - Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me organizata kulturore, shkolla dhe OJQ-të për bashkëpunime të rregullta.							

Tabela në vijim përmbledh aktivitetet konkrete të planifikuara për arritjen e këtij objekti operacional, së bashku me indikatorët e performancës, afatet kohore dhe strukturat përgjegjëse për zbatim.

OBJEKTIVI OPERACIONAL		7:		QEVERISJA INSTITUCIONALE, ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE			
QËLLIMI:	Ky objektivi operacional shërben si bazë mbështetëse për të gjithë objektivat e tjerë dhe ndërlidhet me të gjitha shtyllat e Planit Strategjik, veçanërisht me nevojën për funksionim të mirë organizuar, zhvillim të stafit dhe sigurim të burimeve të qëndrueshme për zbatim të strategjisë. Qëllimi është të përmirësohen mekanizmat e menaxhimit, të rritet transparenca institucionale dhe të ndërtohet një model efikas për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe financiare në përputhje me standardet moderne të qeverisjes universitare.						
TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)							
TREGUESI						TARGET DERI MË 2030	
Mekanizmat e rishikuara të qeverisjes						Të gjitha strukturat	
Sistemi i vlerësimit të performancës së stafit						I implementuar	
Politika për zhvillim profesional të stafit						E miratuar dhe active	
Burime financiare alternative të gjeneruara						≥150,000 €	
Raportim i rregullt vjetor i performancës institucionale						1 raport në vit	
AKTIVITETET KRYESORE							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi i mundshëm	Udhëheqës i i zbatimit	Partnerë të mundshëm	Rezultatet e pritshme
7.1	Rishikimi i strukturës organizative të fakultetit në përputhje me zhvillimet e fundit akademike	2025	0	Fakulteti	Dekanati	UP, Senati	Qeverisje më efikase dhe koordinim i brendshëm më i mirë
7.2	Hartimi dhe zbatimi i një politike për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe përkrahjen e avancimit të stafit	2025–2026	0	Fakulteti	Komisioni për HR	Njësia për Cilësi në UP	Rritje e motivimit dhe profesionalizimit të stafit
7.3	Trajnime periodike për stafin administrativ dhe akademik për menaxhim, teknologji, etikë	Vjetor	20,000	UP, BE	Fakulteti	Qendra për Trajnim e në UP	Staf më kompetent dhe i përshtatur me kërkesat bashkëkohore

7.4	Krijimi i një mekanizmi të brendshëm për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe administrative	2026	2,000	Fakulteti	Administra ta	Ekspert ë të jashtëm	Transparencë dhe përmirësim i vazhdueshëm institucional
7.5	Identifikimi i burimeve alternative të financimit përmes projekteve, partneriteteve dhe shërbimeve	2025– 2030	—	BE, donatorë, të ardhura vetanake	Fakulteti	MKRS, partnerë lokalë	Rritje e autonomisë financiare dhe mundësi për zbatim të projekteve zhvillimore
7.6	Hartimi i raportit vjetor të performancës dhe publikimi i tij për komunitetin	Vjetor	1,000	Fakulteti	Administra ta	—	Rritje e llogaridhënies dhe besueshmërisë institucionale
TOTALI:			23,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Mungesë përfshirjeje nga disa njësi në procese të brendshme				Përcaktim i rolit të secilit grup në vendimmarrje dhe motivim për përfshirje			
Vonesë në miratim të politikave nga instancat qendrore				Koordinim i hershëm me UP dhe paraqitje e politikave të harmonizuara me rregulloret			
Mungesë kapaciteti për menaxhim financiar alternativ				Trajnime dhe këshillim nga ekspertë të jashtëm dhe partnerë strategjikë			
INDIKATORË PËR IMPAKTIN AFATGJATË							
OBJEKTIVI 7	QEVERISJA INSTITUCIONALE DHE QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE						
INDIKATORË IMPAKTI:							
- Rritje e transparencës dhe besueshmërisë institucionale përmes raportimeve vjetore të publikuara. - Ndërtimi i një modeli të qëndrueshëm për menaxhimin financiar dhe burimet njerëzore. - Sigurimi i të ardhurave alternative dhe financimeve të jashtme në mënyrë të vazhdueshme (>150,000€ deri më 2030).							

Njësia për Sigurimin e Cilësisë dhe Zyra e Dekanit do të monitorojnë së bashku indikatorët e rrezikut çdo vit. Të dhënat mbi rrezikun do të përfshihen në raportet vjetore të progresit, ndërsa një rishikim i plotë do të realizohet në vitin 2027 si pjesë e vlerësimit në mes të periudhës së Planit Strategjik.

Menaxhimi i rrezikut do të integrohet në kalendarin e zbatimit dhe raportet vjetore të progresit, duke siguruar përputhje ndërmjet planifikimit, zbatimit dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Shtesat Tematike

Shtojca A: Inovacioni artistik, kërkimi ndërdisiplinor dhe lidhja me industrinë krijuese

Kjo shtojcë zgjeron Planin e Veprimit të Fakultetit duke përfshirë iniciativa specifike për kërkimin shkencor, inovacionin, infrastrukturën, pronësinë intelektuale dhe qeverisjen e avancuar — të frymëzuara nga plani i detajuar i Departamentit të Arteve Vizuale.

Shënim: Këto masa janë të përfshira në Objektivin 3 – Kërkimi dhe Projektet Krijuese.

OBJEKTIVI SHITESË A:

QËLLIMI:

Kjo shtojcë tematike thekson nevojën për zhvillimin e një kulture të inovacionit dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor në kuadër të Fakultetit të Arteve, duke përfshirë fusha si dizajni, teknologjia digjitale, prodhimi i zërit, arti performativ dhe prodhimi vizual. E ndërlidhur ngushtësisht me Objektivin Strategjik 2 dhe 4, kjo shtojcë synon krijimin e hapësirave eksperimentale dhe strukturave të qëndrueshme për bashkëpunim me sektorin kulturor dhe kreativ në vend dhe jashtë tij.

TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)

TREGUESI

TARGET DERI MË 2030

Projekte të inovacionit artistik të realizuara

≥15 projekte ndërdisiplinore

Partneritete me sektorin kreativ

≥10 bashkëpunime

Iniciativa të studentëve në fushat e teknologjisë & artit

≥5 iniciativa të mbështetura

Punëtori/ekspozita/rezidenca me qasje eksperimentale

≥2 në vit

AKTIVITETET SHITESË KRYESORE

Nr.

Aktiviteti

Afati kohor

Kosto (€)

Financimi i mundshëm

Udhëheqësi i zbatimit

Partnerë të mundshëm

Rezultatet e pritshme

A1

Themelimi i Laboratorit për Inovacione Artistike në kuadër të Qendrës për Hulumtime

2026

120,000

BE, MKRS, UP

Fakulteti

Agjenci kulturore, startup

Hapësirë për zhvillim projektesh eksperimentale me artistë dhe studentë

A2

Program pilot për ndërveprim mes artit dhe teknologjisë në bashkëpunim me industrinë kreative

2026–2028

27,000

Erasmus+, donatorë lokalë

Fakulteti

Kompani kreative, media

Projekte reale të bazuara në kërkesa të tregut dhe zhvillim portofoliosh për studentët

A3

Organizimi i ekspozitave, punëtorive dhe performancave me studentë dhe

Vjetor

110,000

MKRS, UP

Departamentet

Galeri, platforma online

Krijimi i platformave bashkëpunuese me qasje publike

	profesionistë të fushave të përziera						
A4	Pjesëmarrje në rrjete evropiane për art + teknologji (si STARTS, ISEA, Ars Electronica)	2025–2030	35,000	UP, BE, sponsorë privatë	Qendra për Hulumtim	Rrjete ndërkomb ëtare	Integrim institucional në qendra dhe rrjete për inovacion të avancuar artistik
A5	Krijimi i programeve të reja ose moduleve për artin digjital, AI në art, dizajn të zërit etj.	2026–2030	30,000	UP, Erasmus+	Këshillat e programev e	Universite tet partnere	Përputhje me nevojat e reja të tregut dhe fushat hibride të artit bashkëkohor
GJITHSEJ:			332,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Rezistencë ndaj fushave hibride/te reja				Promovim, përfshirje në kurrikulë dhe demonstrim i vlerës së tyre përmes projekteve			
Vështirësi në sigurimin e pajisjeve teknologjike				Partneritete me kompani dhe aplikime në grante infrastrukturore			
Mungesë përvoja në menaxhimin e projekteve të mëdha				Bashkëpunim me mentorë të jashtëm dhe trajnime për koordinim projektsh ndërkombëtare			

Shtojca B: Digjitalizimi i avancuar dhe modernizimi i kampusit							
OBJEKTIVI SHITESË B:							
QËLLIMI:	Kjo shtojcë tematike zgjeron përmbajtjen e Objektivit Strategjik 3 dhe lidhet ngushtë me Objektivin e Veprimit 4. Synimi është të avancohen më tej aspektet digjitale të mësimdhënies, kërkimit, administrimit dhe ndërveprimit institucional përmes investimeve strategjike në pajisje, softuerë, siguri kibernetike dhe transformim të hapësirave fizike të kampusit në mjedise fleksibile dhe inteligjente për të nxënë dhe krijuar. Shënim: Kjo shtojcë tematike i përgjigjet plotësisht Objektivit 4 – Infrastruktura dhe Digjitalizimi.						
	TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)						
	TREGUESI						TARGET DERI MË 2030
	Hapësira të digjitalizuara për mësim dhe krijimtari						≥15 hapësira të pajisura
	Sisteme online për menaxhimin akademik dhe komunikim						Në të gjitha programet
Pajisje dhe softuerë për kërkim dhe dizajn						Të blera dhe funksionale	
Kapacitet i shtuar për mësim në distancë dhe përqasje hibride						I integruar për çdo profil	
AKTIVITETET SHITESË							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi i mundshëm	Udhëheqësi i zbatimit	Partnerë të mundshëm	Rezultatet e pritshme
B1	Hartimi i një strategjie të integruar për digjitalizimin në fakultet	2025	0	Fakulteti	Dekanat i	Këshilli i UP për IT	Dokument strategjik për zhvillim të qëndrueshëm digjital
B2	Pajisja me kompjuterë, tableta grafike, skanerë, pajisje audio/video për laboratorët krijues	2025–2027	200,000	UP, IPA, Erasmus+, MKRS	Fakultet i	Furnitorë vendorë, donatorë	Përmirësim i ndjeshëm i infrastrukturës për art digjital, prodhim zanor dhe vizual
B3	Integrimi i softuerëve profesionalë për krijimtari, dizajn dhe prodhim në kurrikulë	2026–2028	50,000	UP, licenca edukative	Departamentet	Adobe, Ableton, Autodesk	Rritje e përgatitjes teknike të studentëve për tregun modern të punës
B4	Platformë e përbashkët online për menaxhim orarësh, lëndësh, projekteve të studentëve	2026	15,000	UP, BE	Sekretaria	Zhvillues lokalë të platformave	Menaxhim më i efektshëm dhe transparent i procesit mësimor
B5	Përdorimi i klasave digjitale për mësim në distancë dhe	2025–2030	30,000	Erasmus+, partnerë BE	Fakultet i	Universitete evropiane	Klasë bashkëkohore dhe mjedis fleksibil për

	prezantime ndërkombëtare						bashkëpunim ndërkombëtar
B6	Krijimi i një Qendre për Edukim Digjital dhe përkrahje teknologjike për studentë dhe staf	2026– 2030	150,000	IPA, BE	Fakultet i	Qendra për Zhvillim në UP	Mbështetje teknike për projekte digjitale, portfoliot dhe kërkime të bazuara në teknologji
B7	Pajisja e hapsirave me instrumente muzikore, pajisje pune për artet tradicionale, pajisje teknologjike për xhirim	2026- 2027	150,000	UP, BE	Fakultet i	Furnitorë vendorë, donatorë	Përmirësim i ndjeshëm i infrastrukturës për art digjital, prodhim zanor dhe vizual
GJITHSEJ:			595,000				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Mungesë fondesh për pajisje dhe mirëmbajtje				Aplikim në fonde IPA/BE, partneritete me sektorin privat			
Përdorim joefikas i teknologjisë së avancuar				Trajnime dhe mentorim për staf dhe studentë, integrim në planifikim pedagogjik			
Vështirësi në mirëmbajtjen e softuerëve dhe sistemeve				Ndërtimi i një shërbimi të brendshëm IT dhe bashkëpunim me qendrat teknologjike të UP			

Shtojca C: Etika institucionale, integriteti akademik dhe pronësia intelektuale							
OBJEKTIVI SHITESË C:							
QËLLIMI:	Kjo shtojcë tematike adreson përkushtimin e Fakultetit të Arteve për të ndërtuar një kulturë akademike të bazuar në etikë, përgjegjësi dhe mbrojtje të të drejtave intelektuale. E ndërlidhur me të gjitha objektivat strategjikë, ajo thekson rëndësinë e ndërtimit të një mjedisi krijues dhe arsimor që promovon ndershmërinë, respektin për autorësinë, transparencën në vlerësim dhe lirinë krijuese të mbështetur në standarde ligjore dhe morale.						
	TREGUESIT E PERFORMANCËS (KPI)						
	TREGUESI				TARGET DERI MË 2030		
	POLITIKA PËR INTEGRITETIN AKADEMIK TË MIRATUAR DHE AKTIVE						
	Manual për pronësinë intelektuale dhe licenca krijuese				1 i implementuar		
Trajnime për etikën akademike për studentë dhe staf				≥2 në vit			
Raste të shmangura të plagjiaturës përmes vetëdijesimit				Ulje progresive çdo vit			
Pjesëmarrja në ngjarje mbi të drejtat autoriale				≥5 për periudhën 2025–2030			
AKTIVITETET KRYESORE							
Nr.	Aktiviteti	Afati kohor	Kosto (€)	Financimi i mundshëm	Udhëheqës i zbatimit	Partnerë të mundshëm	Rezultatet e pritshme
C1	Hartimi dhe miratimi i Kodit të Etikës dhe Manualit për Integritet Akademik	2025	0	Fakulteti	Komisi oni për Etikë	UP, Këshilli i Etikës	Dokument referues për të gjithë anëtarët e komunitetit akademik
C2	Trajnime për studentët dhe stafin mbi parandalimin e plagjiaturës, citimin korrekt dhe etikën e vlerësimit	Vjetor	8,000	UP, donatorë	Sekretaria akademike	Qendra për Cilësi në UP	Rritje e ndërgjegjësimit dhe respektimit të standardeve etike
C3	Ndërtimi i një databaze të veprave studentore për ruajtjen dhe referencimin e pronësisë intelektuale	2026	10,000	Fakulteti	IT & QH	Biblioteka, partnerë ligjorë	Dokumentim dhe arkivim i trashëgimisë krijuese studentore dhe stafit
C4	Futja e një moduli në kurrikulën BA/MA për të drejtat autoriale, Creative Commons dhe menaxhimin ligjor të veprave	2026–2027	0	UP	Departamentet	Juristë, OJQ ligjore	Edukim ligjor bazë për artistët e rinj mbi të drejtat dhe licencimin
C5	Organizimi i debateve dhe ekspozitave mbi	2025–2030	5,500	Fakulteti	Studentët & Alumni	Platforma të artit bashkëkohor	Nxitje e reflektimit etik në procesin krijues dhe zgjatje

	temën e autorësisë, kopjimit dhe transformimit krijues						e dialogut me publikun e gjerë
GJITHSEJ:			23,500				
RREZIQET DHE MASAT PARANDALUESE							
RREZIKU				MASA PARANDALUESE			
Mungesë e njohurive mbi etikën akademike				Zbatim i trajnimeve të detyrueshme në fazën fillestare të çdo cikli studimi			
Vështirësi në implementim për shkak të kulturës ekzistuese				Proces gradual me mbështetje të stafit dhe studentëve përmes shembujve pozitivë dhe mentorimi			
Mospërdorim i databazës për vepra studentore				Krijimi i kushteve të qarta ligjore dhe teknike për sigurinë dhe qasjen në përputhje me GDPR			
Kjo shtojcë është thelbësore për të siguruar që kreativiteti, liria artistike dhe arritjet akademike të zhvillohen në një kuadër të përgjegjshëm dhe të drejtë, duke përbushur një ndër kërkesat më të rëndësishme të akreditimit etik dhe ligjor në arsimin e lartë.							

8. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi

Ky kapitull përshkruan mekanizmat institucionalë për monitorimin sistematik, raportimin periodik dhe vlerësimin e progresit në zbatimin e Planit të Veprimit 2025–2030, si pjesë përbërëse e operacionizimit të objektivave strategjike të Fakultetit të Arteve. Qasja e zbatuar bazohet në ciklin e përmirësimit të vazhdueshëm institucional dhe në integrimin e qëndrimeve dhe kontributit të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, në përputhje me standardet ESG dhe kërkesat e KShC-së.

Monitorimi do të realizohet çdo vit nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë, në bashkëpunim të ngushtë me Dekanatin dhe njësitë përkatëse akademike dhe administrative. Procesi do të mbështetet nga sisteme digjitale për mbledhjen dhe analizën e të dhënave mbi përmbushjen e objektivave operacionale, realizimin e aktiviteteve, përdorimin e burimeve dhe arritjen e indikatorëve të performancës (KPI). Të dhënat do të përpunohen dhe do të përfshihen në një raport të strukturuar vjetor, i cili do të shqyrtohet nga forumet drejtuese të Fakultetit dhe do t'u dorëzohet organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës. Ky raport do të shërbejë si dokument bazë për vlerësimin e progresit institucional dhe përgatitjen për proceset e akreditimit dhe rivlerësimit.

Në vitin 2027 është planifikuar të realizohet një vlerësim i ndërmjetëm gjithëpërfshirës i zbatimit të Planit të Veprimit, si pjesë e ciklit të monitorimit në mes të periudhës. Ky proces do të përfshijë:

- Analizën e arritjes së objektivave operacionale;
- Rivlerësimin e indikatorëve kyç të performancës (KPI);
- Rishikimin e prioriteteve strategjike;
- Përshtatjen eventuale të aktiviteteve të planifikuara.

Rishikimi do të udhëhiqet nga Grupi për Monitorim Strategjik, në bazë të të dhënave të grumbulluara gjatë fazës së parë të zbatimit, dhe do të marrë parasysh zhvillimet kontekstuale, përfshirë ndryshimet në politikat arsimore, zhvillimet socio-ekonomike, burimet në dispozicion dhe dinamikat institucionale brenda dhe jashtë Universitetit të Prishtinës.

Rezultatet e këtij vlerësimi do të shërbejnë për orientimin strategjik të fazës së dytë të zbatimit (2027–2030), duke siguruar që Plani të mbetet i qëndrueshëm, realist dhe në përputhje me nevojat dhe mundësitë aktuale të Fakultetit.

Përmes kësaj qasjeje të strukturuar, Fakulteti i Arteve synon të garantojë transparencë, llogaridhënie dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë, në përputhje me standardet evropiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

Të dhënat e mbledhura nga ky proces nuk do të përdoren vetëm për përmirësimin e brendshëm institucional, por edhe për raportime të jashtme, duke përfshirë proceset e akreditimit institucional dhe programor, vlerësimet ndërinstitucionale dhe bashkëpunimet ndërkombëtare.

8.1. Mekanizmat dhe Mjetet për Monitorimin dhe Raportimin e Planit të Veprimit

Zbatimi efektiv i Planit të Veprimit 2025–2030 do të mbështetet në një sistem të integruar monitorimi dhe raportimi, që ndërtohet mbi përfshirjen institucionale, përdorimin e mjeteve digjitale dhe analizën e rregullt të të dhënave mbi performancën. Këto mekanizma sigurojnë ndjekjen transparente, të koordinuar dhe të matshme të progresit, në përputhje me parimet e standardeve ESG dhe kërkesat e KShC-së për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë.

8.1.1 Mekanizmat Institucionalë Kryesorë

- Grupi për Monitorim Strategjik, i emëruar nga Këshilli i Fakultetit, përbëhet nga përfaqësues të tri departamenteve, sekretarisë, Zyrës për Cilësi dhe përfaqësues të studentëve. Ky grup ka mandat për të ndjekur progresin e Planit dhe për të ofruar rekomandime për përmirësim të vazhdueshëm.
- Zyra për Sigurimin e Cilësisë, si organ teknik përgjegjës për mbledhjen e të dhënave, koordinimin institucional dhe hartimin e raporteve vjetore dhe të ndërmjetme.
- Njësia për Sigurimin e Cilësisë në UP, me të cilën bashkëpunohet për harmonizimin e proceseve dhe integrimin e të dhënave në sistemin universitar të cilësisë.
- Zyra për Projekte dhe Zhvillim Institucional, e cila angazhohet posaçërisht për ndërlidhjen e indikatorëve të progresit me projektet zhvillimore, burimet financiare dhe iniciativat ndërkombëtare.

8.1.2 Mjetet dhe Format e Mbledhjes së të Dhënave

Zbatimi i Planit të Veprimit do të mbështetet në një qasje të shumëanshme për mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e të dhënave, duke kombinuar mjete tradicionale të sigurimit të cilësisë me instrumente digjitale bashkëkohore. Këto mjete sigurojnë transparencë, gjurmueshmëri dhe vendimmarrje të bazuar në evidencë për çdo objektiv operacional.

- **Matrica e Zbatimit:** Për secilin objektiv operacional hartohet një matricë e detajuar që përfshin aktivitetet përkatëse, indikatorët kyç të performancës (KPI), përgjegjësit institucionale, burimet e nevojshme dhe afatet për realizim.
- **Anketa dhe konsultime periodike:** Opinioni dhe përvoja e aktorëve kyç—përfshirë studentët, stafin akademik e administrativ, alumni dhe partnerët institucionale—do të mbledhen në mënyrë të strukturuar përmes anketave, fokus-grupeve dhe konsultimeve publike.
- **Mbledhje të rregullta të Grupit për Monitorim Strategjik:** Ky grup do të mbledhet të paktën një herë në semestër për të shqyrtuar progresin e zbatimit dhe për të dhënë udhëzime për përmirësim të mëtejshëm.

- **Sistemet digjitale për menaxhimin e të dhënave:** Fakulteti do të përdorë platforma të dedikuara për input të decentralizuar nga departamentet, raportim online të progresit, menaxhimin e feedback-ut dhe ndarjen e gjetjeve me palët relevante.
- **Baza e të dhënave të performancës:** Të dhënat e mbledhura do të ruhen dhe analizohen në një bazë të centralizuar, të menaxhuar nga Zyra për Cilësi, me qëllim sigurimin e një analize gjithëpërfshirëse dhe të verifikueshme të progresit institucional.

8.1.3. Raportimi dhe Integrimi i Rezultateve

Procesi i raportimit institucional për Planin e Veprimit është i strukturuar në disa nivele kohore dhe përmbytësore, duke siguruar pasqyrë të qartë të progresit dhe mundësi për përmirësim të vazhdueshëm. Raportet përgatiten dhe menaxhohen nga Zyra për Cilësi në bashkëpunim me Grupin për Monitorim Strategjik dhe forumet drejtuese të Fakultetit.

- **Raporti vjetor i progresit:** Për secilin vit të zbatimit do të hartohet një raport vjetor i strukturuar sipas fushave prioritare dhe objektivave operacionalë. Ky raport do të përfshijë të dhëna për aktivitetet e realizuara, buxhetin e përdorur, indikatorët e arritur dhe sfidat e hasura. Raporti shqyrtohet në forumet drejtues të Fakultetit dhe i dorëzohet organeve përkatëse të Universitetit të Prishtinës.
- **Raporti i ndërmjetëm (2027):** Në mesin e periudhës së zbatimit do të realizohet një raport gjithëpërfshirës për vlerësimin e progresit dhe rishikimin strategjik të Planit të Veprimit. Ky raport do të përfshijë: analizën e përmbytësive të objektivave, rivlerësimin e indikatorëve kyç të performancës (KPI), rishikimin e prioriteteve strategjike dhe përshtatjen e aktiviteteve në përputhje me zhvillimet institucionale dhe kontekstuale.
- **Raporti përmbyllës (2030):** Në fund të periudhës së Planit, do të hartohet një raport final gjithëpërfshirës, i cili do të përfshihet në dosjen për akreditimin e ardhshëm dhe do të publikohet për qëllime transparence dhe llogaridhënie publike.
- **Integrimi i rezultateve:** Gjetjet kryesore nga të gjitha raportet do të integrohen në përditësimin e dokumenteve zhvillimore të Fakultetit dhe do të shërbejnë si bazë për hartimin e Planit të ardhshëm të Veprimit për periudhën pas vitit 2030.

8.2. Tabela e Përgjegjësiwe Institucionale për Zbatimin e Planit të Veprimit

Për të siguruar zbatim të koordinuar, efikas dhe të matshëm të objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit 2025–2030, Fakulteti i Arteve ka përcaktuar qartë përgjegjësitë institucionale sipas fushave prioritare të ndërhyrjes. Përgjegjësia primare për secilën fushë i takon strukturave drejtuese të Fakultetit, ndërsa zbatimi konkret mbështetet nga njësi të specializuara akademike, administrative dhe teknike, në përputhje me natyrën e veprimit dhe kërkesat e strategjisë.

Tabela më poshtë përshkruan rolet kryesore për secilën fushë prioritare, duke përfshirë: institucionin bartës, njësitë mbështetëse dhe frekuencën ose periudhën e zbatimit të parashikuar.

Fusha Prioritare	Përgjegjësia Kryesore	Përgjegjësitë Mbështetëse Institucionale	Afati
Cilësia Akadematike	Dekanati, Këshilli i Cilësisë	Departamentet, Koordinatori për Mentorim	Afat i përsëritur çdo vit
Kërkimi dhe Inovacioni	Koordinatori për Kërkime	Qendra Kërkimore, Departamentet	Afat i përsëritur çdo semestër
Infrastruktura dhe Pajisjet	Drejtorja e Infrastrukturës	Zyra e Prokurimit, Zyra për IT	Afat i përcaktuar: 2025–2028
Ndërkombëtarizimi	Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare	Koordinatorët e mobilitetit	Afat i përsëritur çdo vit
Alumni dhe Komuniteti	Koordinatori për Alumni	Zyra për Projekte dhe Partneritete	Afat i përcaktuar: 2026–2030
Kampusi i Ri	Drejtorja për Projekte Strategjike	Arkitektë, Konsulentë, UP	Afat i përcaktuar: 2025–2029
Etika dhe Barazia	Komisioni për Etikë dhe Barazi	Koordinatori për Barazi, Organizata të Shoqërisë Civile	Afat i vazhdueshëm
Qeverisja dhe Digjitalizimi	Sekretaria, Dekanati	Zyra për IT, Menaxherët e njësive	Afat i përsëritur çdo vit

8.3. Lidhja me Standardet Evropiane të Cilësisë

Zbatimi i Planit të Veprimit 2025–2030 është konceptuar dhe strukturuar në përputhje të plotë me standardet për sigurimin e cilësisë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KShC) dhe udhëzuesin evropian ESG (Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area).

Kjo përputhje përforcon qëndrueshmërinë dhe legjitimitetin e qasjes së Fakultetit të Arteve ndaj menaxhimit të cilësisë, si dhe garanton integrimin e standardeve ndërkombëtare në të gjitha aspektet e planifikimit dhe vlerësimit të performancës institucionale.

Në veçanti, Plani kontribuon në përmbushjen e standardeve ESG në aspektet e mëposhtme:

- **ESG 1.1 – Politikat për sigurimin e cilësisë:** Plani mbështetet në një qasje institucionale për përmirësim të vazhdueshëm dhe përfshin politika të qarta për ndjekjen e objektivave dhe matjen e performancës.
- **ESG 1.3 – Zhvillimi i studentëve:** Përmes mekanizmave për mbledhjen e feedback-ut dhe përfshirjen e studentëve në monitorim, plani siguron që mësimdhënia dhe të nxëniet të mbështeten në të dhëna të verifikuara dhe analiza të strukturuar.
- **ESG 1.7 – Informimi publik:** Raportet vjetore dhe përfundimtare do të jenë të aksesueshme për publikun, duke rritur transparencën dhe llogaridhënien institucionale.
- **ESG 1.9 – Monitorimi dhe rishikimi periodik:** Plani përfshin mekanizma të qartë për monitorim të përvitshëm dhe vlerësim të ndërmjetëm, duke mundësuar rishikimin e strategjisë në përputhje me zhvillimet institucionale dhe kontekstuale.

Përmes kësaj qasjeje të strukturuar, Fakulteti i Arteve siguron jo vetëm përputhshmëri me kërkesat kombëtare për akreditim, por gjithashtu e afirmon veten si institucion që respekton dhe zbaton parimet e sigurimit të cilësisë në nivel evropian.

Të gjitha të dhënat e mbledhura gjatë procesit të monitorimit dhe vlerësimit do të përdoren për:

- Përmirësimin e brendshëm institucional;
- Raportimin e jashtëm për qëllime të akreditimit programor dhe institucional;
- Partneritete ndërkombëtare dhe projekte të përbashkëta;
- Krahasueshmëri me standardet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë.

9. Buxhetimi, Alokimi i Burimeve dhe Qëndrueshmëria Financiare

Ky kapitull paraqet kuadrin financiar të parashikuar për zbatimin e Objektivave Operacionale (OBJ1–OBJ7) përgjatë periudhës së Planit të Veprimt (2025–2030). Ai shërben si vazhdim logjik i kapitullit për Monitorimin dhe Vlerësimin, duke sqaruar se si mbështetja financiare do të mundësojë realizimin efektiv të objektivave strategjike dhe operacionale të Fakultetit të Arteve.

Kapitulli ofron një përmbledhje të kostove të vlerësuara, identifikon burimet e mundshme të financimit dhe i lidh prioritetet financiare me objektivat institucionale. Burimet financiare do të mobilizohen përmes një kombinimi të fondeve të brendshme (vetëfinancim dhe buxheti i Fakultetit), ndarjeve buxhetore nga Universiteti i Prishtinës, mbështetjes kombëtare dhe komunale (p.sh. MKRS, Komuna e Prishtinës), si dhe nga donatorë dhe programe ndërkombëtare, si GIZ, UNDP, IPA III, Erasmus+, Creative Europe, Horizon Europe, Western Balkans Fund dhe Swiss Development Cooperation.

Të gjitha masat e planifikuara janë përkthyer në kosto të vlerësuara, të lidhura me burime të mundshme financimi dhe me përgjegjësi të përcaktuara qartë institucionale. Buxheti funksionon si instrument për zbatimin praktik të planit dhe për monitorim të vazhdueshëm përgjatë gjithë periudhës. Ai është ndërtuar në përputhje të plotë me mekanizmat e monitorimit dhe raportimit të parashikuar në Kapitullin 8, duke garantuar gjurmueshmëri, transparencë dhe përshtatje dinamike me progresin vjetor.

Buxhetimi është konceptuar si proces dinamik dhe i integruar me ciklin institucional të cilësisë. Rishikimi i përvitshëm i alokimeve financiare do të mundësojë optimizimin e burimeve në funksion të performancës, prioritetëve të përditësuara dhe sfidave të hasura gjatë zbatimit.

Për qartësi të shtuar, tabela 9.1a paraqet kostot bazë për secilin objektiv operacional të Planit të Veprimt, ndërsa tabela 9.1b ofron një pasqyrë të aktiviteteve të ndërlidhura dhe shtesave buxhetore të planifikuara gjatë së njëjtës periudhë.

Tabela 9.1a – Alokimi i Parashikuar i Buxhetit sipas Objektivave Operacionale (2025–2030)

Objektivi Operacional	Kosto e Vlerësuar (€)	Burimet Kryesore të Financimit
OBJ1 – Cilësia e Mësimdhënies dhe Mentorimi	€50,000	Universiteti, donatorë
OBJ2 – Reforma e Kurrikulës	€12,000	Buxheti i Fakultetit, MKRS, Komuna
OBJ3 – Kërkimi dhe Projektet Kreative	€332,000	UP, programe të BE-së, Ministria e Kulturës
OBJ4 – Infrastruktura dhe Digjitalizimi	€595,000	UP, IPA III, Erasmus+, Donatorë
OBJ5 – Ndërkombëtarizimi dhe Mobiliteti	€122,000	Erasmus+, Fakulteti, Partnerë
OBJ6 – Bashkëpunimi me Komunitetin dhe Alumni	€47,000	Fakulteti, MKRS, donatorë
OBJ7 – Qeverisja dhe Qëndrueshmëria Financiare	€23,000	Fakulteti, UP, partnerë strategjikë
(shtesë në kuadër të OBJ7) – Etika dhe pronësia intelektuale	€23,500	Fakulteti, UNDP, GIZ
(shtesë në kuadër të OBJ2) – Dizajni dhe publikimi i planit	€5,000	Fakulteti, projekte IPA
TOTAL I PËRGJITHSHËM	€1,209,500	

Alokimi i buxhetit do të rishikohet çdo vit në përputhje me progresin dhe zbatimin e secilit objektivi. Fakulteti i Arteve do të angazhohet në mënyrë aktive për të siguruar burime shtesë përmes partneriteteve strategjike dhe përfshirjes së donatorëve, me qëllim sigurimin e qëndrueshmërisë afatgjatë. Zbatimi i buxhetit do të monitorohet nga Zyra e Dekanit në bashkëpunim me Shërbimet Financiare dhe Njësinë për Sigurimin e Cilësisë, dhe do të raportohen çdo vit si pjesë e përgjegjshmërisë institucionale.


Shënim: Tabela e detajuar e kostove ndodhet në Shtojcën F.

Tabela 9.1b. Tabela përmbledhëse e burimeve financiare sipas objektivave (2025–2030)

Objektivi	Kosto e Përgjithshme (€)	Burimi Kryesor Financiar	Koment
Obj. 1 – Cilësia në mësimdhënie	50,000	UP, donatorë, vetëfinancim	Trajnime, mentorime, sistem vlerësimi
Obj. 2 – Modernizimi i kurrikulës	12,000	MKRS, Erasmus+, fakulteti	Reforma, module të reja, praktika profesionale
Obj. 3 – Kërkimi dhe krijimtaria	332,000	BE, MKRS, UP	Laboratori i hulumtimit, publikime, trajnim
Obj. 4 – Infrastruktura dhe digjitalizimi	595,000	IPA III, UP, partnerë vendorë	Pajisje teknologjike, laboratorë, smart classrooms
Obj. 5 – Ndërkombëtarizimi	122,000	Erasmus+, BE, UP	Mobilitet, module ndërkombëtare, marrëveshje
Obj. 6 – Komuniteti dhe alumnistët	47,000	MKRS, komuna, sponsorë kulturorë	Aktivitete publike dhe platformë për alumni
Obj. 7 – Qeverisja dhe qëndrueshmëria	23,000	UP, vetëfinancim	Trajnime, vlerësim i performancës, raportim
Shtojca A – Inovacioni artistic	332,000 (obj. 3)	Erasmus+, Creative Europe	Laborator inovativ, projekte eksperimentale
Shtojca B – Digjitalizimi & kampusi	595,000 (obj. 4)	IPA III, BE, UP	Edukim digjital, qendra IT, pajisje softuerike
Shtojca C – Etika dhe pronësia intelektuale	23,500	UP, BE, partnerë OJQ	Manuale, trajnime, databazë krijuese
Kosto për dizajn dhe publikim të planit	5, 000	UP, BE, partnerë OJQ	Buxheti i UP,
TOTALI	~1,209.500	Mix i fondeve publike e ndërkombëtare	I shpërndarë në 6 vjet për të gjitha veprimtaritë
<i>Shënim: Shumat janë të përafërta për planifikim strategjik dhe jo buxhet përfundimtar projektimi.</i>			

Ky buxhet orientues është fleksibil dhe do të rishikohet çdo vit në përputhje me progresin real të zbatimit dhe disponueshmërinë e financimit.

Grafiku i Zbatimit të Objektivave të Planit të Veprimit 2025-2030



III. Shtojcat mbështetëse

Shtojcat Mbështetëse ofrojnë informacion të zgjeruar dhe dokumentacion referues që shoqëron zbatimin e Planit të Veprimit 2025–2030. Ato përfshijnë dokumente themelore institucionale, analiza tematike, planifikim buxhetor dhe qasje ndërsektorale të ndërlidhura me objektivat strategjike dhe operacionale të Fakultetit të Arteve. Shtojcat janë të organizuara në mënyrë kronologjike dhe tematike, për të siguruar përputhje të plotë me standardet e cilësisë dhe kërkesat për akreditim institucional dhe programor.

Në përputhje me strukturën e planifikimit strategjik institucional, Fakulteti i Arteve do të përdorë dokumente të miratuara dhe referenca të ligjshme si mbështetje për zbatim dhe akreditim:

Shtojca D: Lista e dokumenteve mbështetëse	
Në përputhje me strukturën e planifikimit strategjik institucional, fakulteti do të përdorë dokumente të miratuara dhe referenca të ligjshme si mbështetje për zbatim dhe akreditim:	
Nr.	DOKUMENTI
1.	Statuti i Universitetit të Prishtinës
2.	Plani Strategjik i Fakultetit të Arteve 2025–2030
3.	Raportet e vetëvlerësimit për programet BA dhe MA në Artet Vizuale
4.	Udhëzimi Administrativ i UP për Cilësi dhe Vlerësim të Performancës
5.	Korniza Evropiane e Standardit për Arsimin e Lartë (ESG)
6.	Strategjia Kombëtare për Zhvillim Kulturor në Republikën e Kosovës
7.	Udhëzuesi për Hartimin e Kurrikulës në Universitetin e Prishtinës
8.	Rregullorja për Mbështetjen e Projekteve Kërkimore dhe Mobilitetin Ndërkombëtar
9.	Dokumentet e Zyrës për Zhvillim Institucional të UP për IPA III dhe Erasmus+
10.	Raporti vjetor i Fakultetit të Arteve (i fundit i dorëzuar në rektorat)

Shtojca E– Qasja institucionale ndaj Barazisë Gjinore dhe Përfshirjes

Fakulteti i Arteve promovon një mjedis të barabartë, gjithëpërfshirës dhe të sigurt për të gjithë anëtarët e komunitetit universitar. Kjo shtojcë përfaqëson angazhimin institucional për barazi gjinore, diversitet dhe përfshirje sociale, duke u ndërlidhur drejtpërdrejt me Objektivin Operacional 7 dhe me politikat për etikë dhe integritet akademik. Qasja e integruar synon të sigurojë pjesëmarrje të barabartë në të gjitha nivelet, të eliminojë barrierat sistemike dhe të krijojë një kulturë organizative të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Në funksion të zbatimit të politikave të barazisë gjinore dhe përfshirjes, Fakulteti i Arteve ka përfshirë në Planin e Veprimit masa konkrete, të cilat përfshijnë:

- | | |
|----|---|
| 1. | Hartimi i një rregulloreje të brendshme për barazi dhe përfshirje; |
| 2. | Realizimi i trajnimeve për sensibilizimin e stafit dhe studentëve; |
| 3. | Monitorimi i përfaqësimit gjinor në strukturat akademike dhe administrative; |
| 4. | Integrimi i temave të barazisë dhe përfshirjes në kurrikula dhe projekte kërkimore. |

Zbatimi i këtyre masave do të mbështetet nga Zyra për Sigurimin e Cilësisë dhe do të përfshihet në raportimet periodike institucionale. Kjo qasje do të mbetet një komponent kyç i përmirësimit të vazhdueshëm dhe një ndër prioritetet strategjike të Fakultetit gjatë periudhës 2025–2030.

Shtojca F – Tabela e buxhetit të përllogaritur (2025–2030)		
FUSHA PRIORITARE / OBJEKTIV	KOSTO E PËRGJITHSHME (€)	BURIMI I FINANCIMIT
Cilësia në mësimdhënie (Obj. 1)	50,000	UP, donatorë, vetëfinancim
Modernizimi i kurrikulës (Obj. 2)	12,000	MKRS, Erasmus+, Fakulteti
Kërkimi dhe krijimtaria (Obj. 3)	332,000	BE, MKRS, UP
Infrastruktura dhe digjitalizimi (Obj. 4)	595,000	IPA III, UP, partnerë vendorë
Ndërkombëtarizimi (Obj. 5)	122,000	Erasmus+, BE, UP
Komuniteti dhe alumnistët (Obj. 6)	47,000	MKRS, komuna, sponsorë
Qeverisja dhe qëndrueshmëria (Obj. 7)	23,000	UP, vetëfinancim
Inovacioni artistik (Shtojca A)	332,000 (obj. 3)	Erasmus+, Creative Europe
Digjitalizimi & kampusi (Shtojca B)	595,000 (obj. 4)	IPA III, BE, UP
Etika dhe pronësia intelektuale (Shtojca C)	23,500	UP, BE, OJQ
Kosto për dizajn dhe publikim të planit	5,000	Buxheti i UP,
GJITHSEJ:	~1,209.500	
OBJEKTI I RI PËR TRI DEPARTAMENTET	15,000,000	Qeveria, donatorë ndërkombëtarë
Burimet: Mix i fondeve publike, vetanake dhe ndërkombëtare		
Shënim: Kjo shumë është orientuese për planifikim strategjik dhe nuk përfaqëson një buxhet të detajuar për projekte individuale. Kostoja e objektit të ri është e paraparë si investim kapital afatgjatë dhe kërkon koordinim institucional me UP, Ministrinë dhe partnerët ndërkombëtarë.		

Plani i Veprimit është hartuar në përputhje të plotë me objektivat, buxhetin dhe afatet e përshkruara në Planin e Zhvillimit 2025–2030 të Fakultetit të Arteve.

Shtojca G. Përputhja me Planin Strategjik dhe Zhvillimor

OBJEKTIV STRATEGJIK	OBJEKTIV NË PLANIN E VEPRIMIT	VEPRIME NË PLANIN E ZHVILLIMIT
OS1 – Cilësia	1, 2	Reforma kurrikulare, mentorime, trajnime
OS2 – Kërkimi	3	Laboratori, publikime, simpoziume
OS3 – Infrastruktura	4	Digjitalizim, pajisje, ndërtimi kampusit
OS4 – Ndërkombëtarizimi	5	Marrëveshje, mobilitet, module në anglisht
OS5 – Komuniteti	6	Alumni, aktivitete publike, lidhje me shkolla
—	7 (Qeverisja)	Zhvillimi i stafit, performanca, transparencë
—	8 (Kampusi i ri) (për të shtuar)	Aneks për ndërtimin e kampusit



Shtojca H – Fjalori i termave dhe akronimeve

Plani i Veprimit 2025–2030 përbën një instrument të rëndësishëm strategjik për avancimin e Fakultetit të Arteve, duke siguruar transparencë, drejtim të qartë dhe përputhje me standardet ndërkombëtare të cilësisë. Ky dokument do të shërbejë si bazë për vlerësimin institucional të performancës gjatë periudhës dhe si referencë kryesore për trupat akredituese.

Kjo shtojcë përmban një përmbledhje të termave dhe akronimeve më të përdorura në Planin e Veprimit, me qëllim të rritjes së qartësisë dhe përputhshmërisë institucionale në zbatim dhe komunikim.

TERMI / AKRONIMI	PËRKUFIZIMI
KPI	Key Performance Indicator – Tregues Kyç i Performancës
ESG	European Standards and Guidelines – Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë
EHEA	European Higher Education Area – Zona Evropiane e Arsimit të Lartë
ECTS	European Credit Transfer and Accumulation System – Sistemi Evropian i Transferimit të Kredive
IPA	Instrument for Pre-Accession Assistance – Instrumenti i Asistencës para Anëtarësimit (BE)
UP	Universiteti i Prishtinës
FA	Fakulteti i Arteve
QA	Quality Assurance – Sigurimi i Cilësisë
RAE	Research, Artistic and Educational activities – Aktivitetet Kërkimore, Artistike dhe Edukative
VR/AR	Virtual Reality / Augmented Reality – Realitet Virtual / Realitet i Shtuar
AI	Artificial Intelligence – Inteligjencë Artificiale
M&E	Monitoring and Evaluation – Monitorim dhe Vlerësim